

Република Северна Македонија
ООУ „НАИМ ФРАШЕРИ
Неготино Полошко



Republika e Maqedonisë së Veriut
SHFK "NAIM FRASHËRI"
Negotinë e Pollogut

RAPORTI I GJYSMËVJETORIT TË PARË PËR PUNËN E SHFK "NAIM FRASHËRI" NEGOTINA E POLLOGUT PËR VITIN SHKOLLOR 2023 /2024



JANAR 2024

PËRMBAJTJA:

1.Hyrja

1.1 Letërnjoftimi i shkollës

1.2Misioni

1.3Vizioni

1.4 Motoja

2.Struktura organizative dhe organizimi i punës së shkollës .

2.1 Stafi mësimor dhe jomësimor.

3.Organizimi i aktiviteteve të kuadrit asimor dhe drejtues

4. Organizimi i mësimdhënies.

4.1 Aktivitetet e ndërmarra për përmirësimin e kushteve të punës.

4.2 Llojet e mësimdhënies.

5. Seksione dhe aktivitete të lira të nxënësve.

6. Seminaret e realizuara në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2023/2024.

7.Pjesëmarrja në gara në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2023/2024.

8.Kontrollëet sistematike gjatë gjysmëvjetorit të parë viti shkollor 2023/2024

9. Vështrim i përgjithshëm i nxënësve dhe paralelet sipas klasave .

9.1 Krahasimi statistikor i gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022 -23/ dhe gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/24.

9.2.Pasqyra e suksesit të përgjithshëm të nxënësve sipas gjuhës mësimore në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2023/2024.

9.3 Pasqyra e mungesave të nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2023/2024.

9.4 Pasqyra e sjelljes së nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2023/2024.

9.5 Pasqyra e nxënësve të çregjistruar në gjysmëvjetorin e parë për vitin shkollor:2023/2024

10. Ndjekja e realizimit të planeve dhe programeve arsimore.

10.1 Vështrimi i dokumentacioneve dhe regjistrave pedagogjik.

10.2 Zbatimi i metodave moderne të mësimdhënies dhe formave të punës .

10.3 Monitorimi dhe vlerësimi i përparimit të nxënësve.

11. Puna e organeve profesionale në shkollë.

12 .Komunikim me opinionin dhe promovimi i shkollës .

I HYRJJE

Raporti për gjysmëvjetorin e parë për punën në SHFQ "Naim Frashëri" Negotinë për vitin shkollor 2023/24 është përgatitur në përputhje me aktivitetet e planifikuara të programit vjetor për punën e shkollës. Në raport tregohen kushtet materialo-teknike për funksionimin e shkollës, organizimi dhe realizimi i punës edukative-arsimore, formimi i veprimtarive jashtëshkollore, bashkëpunimi i mjedisit lokal dhe komunitetit të biznesit, monitorimi, vlerësimi dhe promovimi i punës edukativo-arsimore, puna e organeve profesionale dhe organeve të menaxhimit dhe menaxhimit të shkollës dhe pjesëmarrja në projekte thuhet në raport. Mësimdhënia dhe format e tjera të punës edukative-arsimore realizohen në bazë të Ligjit për arsimin fillor ,planeve dhe programeve vjetore të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Kulturës, Sportit dhe Shkencës dhe Kalendarit për realizimin e punës edukativo-arsimore në klasë.

Mësimdhënia dhe format e tjera të punës edukative-arsimore realizohen në bazë të Ligjit për arsimin fillor planeve dhe programeve vjetore të përcaktuara nga MASH dhe BRO dhe kalendarit për realizimin e punës edukativo-arsimore në klasë, viti shkollor 2023/2024 botuar në Gazetën Zyrtare dhe të gjitha shtesat dhe ndryshimet e tij.

Përmbajtja, rezultatet dhe aktivitetet e paraqitura në Raport lidhen me tregues dhe të dhëna nga:

- Raporte nga udhëheqësi i paraleles
- Raporte nga mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional
- Raport dhe procesverbal për aktivet profesionale
- Raport nga ekipi drejtues i shkollës

1.1 Letërnjoftimi i shkollës

Të dhënat e përgjithshme për shkollën

Emri i shkollës qendrore	SHFK "Naim Frashëri"
Adresa , komuna , vendi	101 p.n. 1235 Negotinë, Komuna e Vrapçishtit
Telefon	042311093
Faks	042311093
Email	ou.naim.frasheri@gmail.com
E themeluar prej	Vitit
Numri i verifikimit – aktit dhe viti i verifikimit	1465/10-1996
Gjuha në të cilën mbahet mësimi	Gjuhë shqipe
Viti i ndërtimit	Viti 1996
Lloji i ndërtimit	Material i forte
Sipërfaqja e objektit	2176m ²
Sipërfaqja e oborit të shkollës	2145m ²
Sipërfaqja e tereneve sportive	1000m ²
Shkolla punon në ndrime	II ndrime
Mënyra e ngrohjes së shkollës	Nxemje qendrore me naftë
Numri i klasave	24
Statusi I eko shkollës (flamuri I gjelbërt , argjend dhe nivel I bronzës)	E planifikuar këtë vit të formohet

1.2 Misioni

SHFK "Naim Frashëri" Negotinë ofron kushte për arsimimin e nxënësve sipas programeve të BYROSË PËR ZHVILLIM TË ARSIMIT.

Në shkollën tonë mbretëron një klimë pozitive që nxit mësimin kreativ e zhvillon mendimin kritik dhe paraqet nxitje intelektuale për të gjithë. Nxënësit janë motivimi ynë, janë shumë të rëndësishme rezultatet dhe të arriturat e tyre, zhvillimi i tyre individual dhe vlerat e tyre njerëzore. Qëllimi ynë është që të zhvillojmë vetëdijen për të dalluar të drejtat dhe obligimet e tyre, për vlerat demokratike dhe bashkëjetesën multikulturore sepse ato do jenë intelektualët dhe akademikët tonë të ardhshëm, pjestarët dhe krijimtarët e shoqërisë, dhe elitave politike.

"Pretendojmë që të jemi shkollë e cila ofron mësim kualitativ dhe edukatë cilësore dhe zhvillimin e karakteristikave individuale të të gjithë nxënësve, ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë dhe integrimin në botën globale dhe digjitale. Të hapur për të gjithë palët që nëpërmjet kreativitetit, mësimin, lojrave të jemi shkollë lider për avansimin e rinisë në botën moderne".

1.3 Vizioni

Me zbatimin e metodave bashkëkohore dhe IT teknologjisë dëshirojmë që kuadri jonë arsimorë t'i realizojë planet dhe programet përkatëse vetëm me një qëllim, ngritjen e kualitetit të procesit edukativo-arsimor dhe respektimin e aftësive individuale të nxënësve. Qëllimi ynë është që shkolla të jetë e integruar në baza të programeve bashkëkohore, tërheqëse dhe efikase për nxënësit, prindërit dhe shoqërinë. Do të mundohemi që shkolla jonë të jetë shkollë avangarde.

"Ne përpiqemi që të jetë shkolla një vend i këndshëm në të cilën nxënësit do marrin jo vetëm njohuri, por edhe aftësitë, shkathtësi dhe qëndrimet për të qenë qytetarë të denjë"

1.4. Motoja

"DUKE EDUKUAR NJË FËMIJË SOT, EDUKOJMË NJË POPULL NESËR".

2.Struktura organizative dhe organizimi i punës së shkollës

2.1 Stafi mësimor dhe jomësimor

Mësimin e zhvillojnë 94 mësimdhënës të shpërndarë në shkollën fillore dhe 4 shkollat periferike për mbarvajtjen e procesit mësimor kujdeset edhe shërbimi pedagogjik , me qëllim që të zotëronte detyrat e punës së kësaj shkolle.

Puna administrative në shkollë bëhet nga sekretari-administratori dhe bibliotekisti.Stafi teknik numëron 11 persona që punojnë me kohë të plotë .

STAFI MËSIMOR DHE JOMËSIMORS		Gjithësejt
Nr i të punësuarve		112
Drejtor, Nd.Drejtor		2
Nr.i mësimdhënësve		94
Nr.i shërbimit pedagogjik		4
Administrator		1
Shërbimi teknik		11

- Mësuesit që plotësuan mësimin nga shkollat e tjera

1	Sara Mexhidi	Biologji
2	Zekirja Rushani	Etikë religjioni

- Shkalla e përgatitjes profesionale të stafit mësimdhënës dhe profesional

Profili	Dr.	Mr.	VII-1	VI
Drejtor		1		
Nd.drejtor			1	
Pedagog			1	
Psikolog			1	
Edukator special.rehabilitator			1	
Mësimdhënës		5	73	16
Sekretar			1	

	<u>3. ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE TË KUADRIT ARSIMOR DHE DREJTUES</u>
<u>KËSHILI I SHKOLLËS</u>	Anëtarët e këshillit drejtues të shkollës: Rijat Bajrami- KRYETAR Lindihana Ebibi- anëtar (KOLEKTIVI) FetaneteAdilii- anëtar (KOLEKTIVI) Rizvan Asani –anëtar(KOLEKTIVI) Ramis Imeri-nënkryetar (PRINDËRIT) Agim Jonuzi-anëtar (PRINDËRIT) Shenazi Salija-anëtar (Themeluesi-Komuna) Këshilli i shkollës për gjysmëvjetorin e parë të këtij viti ka mbajtur gjithsej 2 mbledhje. Këshilli i shkollës miratoi këto dokumente: -Programin vjetor të punës dhe e miratoi raportin e punës -Propozim planin financiar deri të ministria propozon llogarinë përfundimtare - Shqyrton çështje të tjera të përcaktuara me Statutin e shkollës -Zgjedhja e këshillit të ngushtë në këshillit të prindërve -Miratimi i programës së ekskursioneve shkollore për vitin 2023/24 -Miratimi i programës për punë të këshillit të prindërve -Të ndryshme

<u>KËSHILLI I ARSIMTARËVE</u>	Këshilli i Arsimitarëve gjysëmvetorin e parë të vitit shkollor 2023/24 ka mbajtur 2 mbledhje ku janë shqyrtuar këto aspekte të procesit mësimor : -Kalendar i punës në vitin shkollor 2023/24 -Puna organizative në vitin shkollor 2023/24 -Mendimi i marrë nga ana e arsimtarëve për praktikantët në vitin shkollor 2023/24 -Realizimi i planprogrameve mësimore sipas periudhave klasifikuese: për tremujorin e parë ,dhe gjysëmvetorin e parë të vitit shkollor 2023/24 -Suksesi dhe sjellja e nxënësve sipas periudhave klasifikuese: për tremujorin e parë , dhe gjysëmvetorin e parë të vitit shkollor 2023/24 -Realizimi i mbledhjeve prindërore -Të ndryshme
KËSHILLI I PARALELEVE PËR VITIN SHKOLLOR	Organizojnë dhe realizojnë procesin mësimor në tërësi i mbledhin rezultatet e punës së nxënësve sipas periudhave klasifikuese i përcaktojnë notat e tremujorit të parë tremujorit të dytë dhe gjysëmvetorit të parë të vitit shkollor 2023/24, shqiptimi i masave pedagogjike, bashkëpunim me këshillin e prindërve dhe propozim masa deri te këshilli i arsimtarëve për tejkalim të dobësive të caktuara gjatë punës.
KËSHILLI I PRINDËRVE	Këshilli i prindërve përbëhet prej përfaqësuesve të prindërve që nuk janë të punësuar në shkollë . Në gjysëmvetorin e parë u realizuan 2 mbledhje me këshillin e prindërve dhe e përcolli zhvillimi e punës edukative arsimore të shkollës duke dhënë mendime dhe propozime për avancimin e saj. Kryetar i këshillit të prindërve Rijat Bajrami dhe nënkryetare Ramis Imeri

KUJDESTARËT E KLASAVE	Përcollën punën dhe dicitlinën e nxënësve u kujdesën për realizimin e rregullt të procesit mësimor në klasë ,arsyetimet mungesat e nxënësve ,shqiptimin e masave pedagogjike, shpërblimeve ,bashkëpunim i vazhdueshëm me prindërit e nxënësve . Në gjysmëvjetorin e parë janë realizuar dy mbledhjeve prindërore ku është diskutuar për : -Strukturën e nxënësve në paralele dhe bashkësia e klasës -Vërtetim i planit vjetor dhe bashkëpunimi me prindërit -Furnizimi i nxënësve me libra dhe përgaditje shkollore -Rregullshmëria e nxënësve dhe kontributi i tyre në edukim -Suksesi dhe sjellja e nxënësve sipas periudhave klasifikuese: për tremujorin e parë ,dhe gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2023/24 -Kujdesi i shkollës për shëndetin e nxënësve. -Kushtet për jetë në shkollë dhe në shtëpi -Kujdesi i shkollës për shëndetin e fëmijëve dhe ngritja e humanitetit. -Të ndryshme .
AKTIVET PROFESIONALE DHE AKTIVITETET E TYRE	Aktivitetet profesionale i fokusuan aktivitetet e tyre drejt përsosjes dhe adaptimit të programeve në nivel të moshës së nxënësve ,modernizimit të procesit mësimor dhe standardizimit të vlerësimeve ,zbatimit të procesit bashkëkohor arsimor me implementimin e teknikave të reja të mësimit ,bashkëpunimit me prindërit dhe nxënësit,përsosja profesionale e arsimtarëve me vizitë të seminareve ,ligjëratave etj. Gjithashtu aktivitetet profesionale u angazhuan në realizimin e aktivitetetve mësimore ,punë me nxënësit me arritje të dobëta ,përgatitja e nxënësve për gara komunale,rajonale,shtetërore

PARLAMENTI I NXËNËSVE

Parlamentin e nxënësve e përbëjnë kryetarët e klasave nga klasa e V-IX ku përfshihen nxënësit e SHFQ-Negotinë dhe nxënësit e SHFP-Senakos ,Kalisht

Në fillim të vitit shkollor u zgjodh ekipi udhëheqës i parlamentit të nxënësve ,të drejtë vote kishin nxënësit nga klasa e VII-IX –ta :

Kryetar i parlamentit të nxënësve –Bleona Pajaziti klasa IX/1

Nënkryetar i parlamentit të nxënësve –Emine Musliu klasa IX/4

Avokat i nxënësve –Mejreme Kurtishi Klasa IX/5

Zëvendës avokat :Arjan Imeri klasa IX/6

Në gjysëmjetorin e parë të vitit shkollor janë realizuar tre mbledhje me parlamentin e nxënësve ku është diskutuar për :

- Aktivitete jashtëmësimore dhe manifestimet e ndryshme
- Projektet që do të realizohen në vazhdim
- Suksesin , vijueshmërinë e nxënësve
- Sugjerimet dhe ankesat
- Mbarrëvajtja e procesit edukativo-arsimor etj.

PROGRAMI PËR PUNËN E DREJTORIT TË SHKOLLËS -BEJTULLA KAMBERI Përbajtja programore dhe detyrat e punës në shkollë	BARTËSI DHE BASHKËPUNËTORËT	KOHA E REALIZIMIT
-Analiza e vitit të mëparshëm shkollor, masat për përmirësimin e organizimit dhe punën e shkollës; - Mendjehollësi mbi gatishmërinë teknike dhe të tjera për punë të shkollës -Planifikimi për rishpërndarjen e klasave dhe kabineteteve; - Planifikimi dhe organizimi i riparimeve të inventarit të shkollës, pikturës dhe pikturës; - Planifikimi i burimeve të reja mësimore dhe ndihmave për vitin e ri shkollor	Shërbimi pedagogjik mësimdhënës	Gusht
-Organizimi operacional i aktiviteteve për fillimin e vitit shkollor 2023/24 - Sigurimi i kushteve të punës; - Paisje profesionale dhe të personelit; - Koordinimi i personelit të higjenës dhe teknikës; - Formimi i klasave, formimi i paraleleve ,grupet edukativo arsimore, ndarjen e orëve ,klasave, paraleleve mësuesve, kujdestarëve, përcaktimit të kujdestarëve të klasave. -Formimi i grupeve , aktivet profesionale mësues përgjegjës -Aktivitete për informin më të mirë për të gjithë të punësuarit,sigurim i obligimeve të sakta të qarta dhe precize - Tabelë informative për mësimdhënësit ,prindërit ,nxënësit nëpër shkollë - Përgaditje për pranimin e fillestarëve më 1. Shtator -Formimi i anketës pyetësorit për nxënës ,mësimdhënës dhe prind.	Drejtore, institucionet kompetente,komuna mësues të punësuar	Gusht Shtator
-Krijimi i pyetësorit për mësuesit (shkalla , tip dhe nevojë për trajnim) - Analiza e përgjigjeve, nevojave dhe marrjes së aktiviteteve - Zhvillimi i një programi operacional për trajnimin e brendshëm të mësuesëve -Marketingu shkollor, puna publike, faqja e Facebook e shkollës	Drejtore, pedagog, mësimdhënësi përgjegjës.	Tetor Nëntor
-Puna me komisione - kordinimi i grupit punues -Shikim i organizimit të punëve ditore :dokumentacionit pedagogjik ,dokumentacionet elektronike - Bashkëpunimi me institucionet kompetente; - Mendjehollësi për organizimin e përditshëm të punës, koordinimit;; - Udhëzime, mbështetje në përgatitjet për shënimin e datave më domethënëse	Drejtore, shërbimi pedagogjik, mësuesit, institucionet kompetente	Nëntor Dhjetor

- Trajnimi i kuadrit mësues mbi kompetencat, aftësitë, njohuritë e nevojshme në Arsimin e shekullit të 21 të - Trajnim për karakterin profesional dhe moral të mësuesit sipas nevojave dhe kërkesave të nxënësve - Trajnim për punë ekipore në shkollë; - Demonstrim dhe prezantim për aplikimin e metodave dhe teknikave moderne në mësim.	Drejtor, pedagog, mësuesi përgjegjës	Tetor Nëntor Dhjetor
- Pjesëmarrja në kërkime mbi çështjet aktuale-arsimore - Përpilim i dokumentacionit dhe instrumenteve për të monitoruar realizimin e programit; - Monitorim i vazhdueshëm mbi risitë në arsim në shekullin e 21-të	Mësues, pedagog institucionet kompetente	Vazhdimësi
- Përpilimi i raportit në gjysmëvjetor dhe vjetor - Pjesëmarrja në pazarin, vitin e ri dhe aktivitetet shkollore . - Përmbledhja e të dhënave në gjysmëvjetorin e parë	Mësues përgjegjës, pedagog, mësues	Dhjetor
- Përgatitja për gjysmëvjetorin e dytë - Riparimet e shkollës, gjatë pushimeve dimërore - Përgatitja dhe zhvillimi i planeve operacionale për mbikqyrjen e punës në shkollë	Pedagog, mësues institucionet kompetente	Janar Shkurt
- Analiza e mungesave dhe vështirësive në çdo paralele - Analiza për tremujorin e parë dhe gjysmëvjetorin e parë ,analizë për arritjet në fund të vitit shkollor - Aktivitetet dhe ndihma në organizimin e garave të nxënësve; - Theksimi i punës në ekip në krijimin e një baze elektronike të dhënash	Mësues përgjegjës, pedagog ,mësues	Shkurt Maj Qershor
- Analiza dhe përmbledhja e të dhënave të tremujorit të tretë dhe plani për përmirësimin e cilësisë për përfundimin me sukses të vitit shkollor; - Plan operacional për punën në ekip, takimet , informim i mësuesve - Propozim masa për përmirësimin e suksesit të përgjithshëm dhe arritjes së nxënësve - Shikim mbi të dhënat dhe dokumentacionin pedagogjik, përgatitjet e përditshme, e-ditarin;	Pedagog, mësues	Prill Maj Qershor

Programi vjetor për punën e ndihmës drejtorit

Ndihmës drejtor: Rabi Ismaili

Ndihmësdrejtori i shkollës ndihmon drejtorin në organizimin e menjëhershëm të punës në shkollë.

Realizon bashkëpunim të vazhdueshëm me shërbimet profesionale (pedagog, psikolog, ed. Special, Bbliotekist), Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Prindërve)

Këshillin e shkollës dhe të gjitha organet dhe strukturat e tjera që funksionojnë në shkollë si dhe vetë komunën.

Në realizimin e tyre detyrimet dhe operacioni ka këto detyra:

- Kujdeset për kryerjen në kohë të punës në shkollë;
- Kujdeset për përgatitjen në kohë të programit vjetor dhe zbatimin e tij me sukses;
- Bashkëpunon me shkollat periferike në fshatin Senakos, fshatin Kalisht, fshatin Gjurgjevisht dhe fshatin Llomnic;
- Ndihmon drejtorin në përgatitjen e seancave të organeve profesionale të shkollës;
- Në mungesë të drejtorit, menaxhon organizimin dhe punën e përgjithshme të shkollës;
- Kujdeset për përmirësimin e kushteve të punës dhe mbarrëvajtjen e aktiviteteve të shkollës;
- Bashkëpunon me shkollat e tjera për përmirësimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëshkollore në shkollë;
- Kur ka nevojë kryen punë edukative;
- Monitoron punën e aseteve profesionale;
- Kujdeset për ligjshmërinë e punës së shkollës dhe zbatimin e tyre;
- Bashkëpunon me shërbimin pedagogjik-psikologjik, drejtues departamentesh dhe personel tjetër arsimor, me prindërit e nxënësve si dhe më gjerë;
- Inspekton suksesin, mungesat dhe sjelljen e nxënësve, dorëzon raporte për nevojat e komunës, BZHA-së, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës , institucionet shkencore dhe sociale e të tjera ;
- Kujdeset për rendin dhe disiplinën në shkollë dhe mirëmbajtjen e tyre;

Ndihmësdrejtori i shkollës mund të kryejë edhe detyra të tjera në pjesën e procesit arsimor për të cilin do të jetë i autorizuar nga drejtori i shkollës përgjigjet para drejtorit të shkollës për detyrat dhe detyrimet e tij.

Raport për punën e ndihmës drejtorit në gjysmëvjetorin e parë 2023/20234

- Përpilimi i orarit mësimor për mësidhënësit e ciklit të ulët dhe të lartë në shkollë
- Caktimi i kujdestarisë në shkollë
- Kontrollëimi i emailave të ardhura në ou.naim.frashëri@gmail.com dhe shpërndarje në shërbiimet përkatëse
- Plotësimi i formulareve në mënyrë elektronik dhe në formë të shkruar të entit statistikor për mbarimin e vitit shkollor 2022/23 dhe fillim i vitit 2023/24
- Regjistrimi i nxënësve të klasave të para në librin amë
- Realizimi i mbledhjeve me këshilli e arsimtarëve në shkollat periferik në Kalisht, dhe Llomnic
- Bashkëpunim me shërbimin pedagogjik-psikologjik, arsimor dhe teknik
- Kujdesi për rendin dhe disiplinën në shkollë dhe mirëmbajtjen e tyre
- Bashkëpunim me shkollat e tjera për përmirësimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore
- Bashkëpunim me përgjegjesat e shkollave periferike në fshatin Senakos, fshati Kalisht, fshati Gjurgjevisht dhe fshati Llomnic
- Organizimi i panairit të ushqimit, si koordinator
- Vëzhgim nëpër orët mësimore dhe orët e hapura
- Përpilim i statistikave dhe shpërndarja e tyre nëpërmjet emailit të shkollës të kujdetareve të klasave

RAPORT PËR PUNËN E PEDAGOGUT TË SHKOLLËS – Ferdane Veija

Muajt dhe orët	Përmbajtja	Qëllimi	Koha e realiz.	Loji i punës(forma)	Efektet dhe bashkëpunëtorët
Gusht	Përpilimi i programit vjetor të pedagogut	Planifikimi vjetor i punës		Programi	Pedagogu.PsikologuDrejtori
	Përpilimi i programit vjetor të shkollës	Modele si programme të veçanta për aktivitetet jashtë mësimore	24	===//===	===//===
	Pjesëmarrje në punën e aktiveve profesionale	Formimi dhe planifikimi i punës së organeve profesionale	8	===//===	Arsimtarët përgjegjës të aktiveve,pedagog, drejtor
	Pranimi i nxënësve në klasën e parë	Për nxënësit që nuk kanë ardhur në kohë dhe nuk janë regjistruar gjatë muajit Maj.	24	Udhëzime,sqarime	Prindërit-Pedagogu,Psikologu
	Formimi i paraleleve, kl.I dhe kl. VI	Rradhitja e drejtë e nxënësve nëpër klasa	8	===//===	Drejtori-Pedagogu,Psikologu
Shtator	Pranimi i fëmijëve në kl. të parë	Dita e parë në shkollë	8	===//===	Drejtori,Pedagogu,Psikologu dhe Edukatorët
	Pranimi dhe evidentimi i të dhënave për fëmijët e kl. të parë.	Dita e parë në shkollë	8	===//===	Arsimtarët dhe prindërit
	Punë këshilldhënëse-konsultative me prindërit e fëmijëve e kl. parë.	Sjellja jo e përshtatshme e fëmijëve të tyre në ditët e para në shkollë	16	===//===	===//===

	Punë këshilldhënëse me e arsimtarët e klasës VII.VIII, IX reth planprogramit të ri mësimor(2023/2024)	Që arsimtarët të informohen më sakt rreth planprogramit të ri,lëndëve zgjedhore dhe me librat e reja për këtë vit shkollor.	16	===//===	===//==
	Punë këshilldhënëse- konsultative me arsimtarët(konstatimi i ditareve të klasës,planifikimi,aktivitetet)	Rikompletimi dhe ripërpunimi i orareve mësimore,planprogrameve mësimore,përgatitjeve ditore.	16	Punë këshilldhënëse-konsultative	Pedagogu-arsimtarët
	Kontrollëimi i evidences pedagogjike	Verifikim i ditareve të klasave,planeve dhe aktiviteteve	24	Kontrollëim	Kujdestarët e klasave
	Punë këshilldhënëse me arsimtarët	Ndihmë arsimtarëve të ri	16	Punë këshilldhënëse-konsultative	Arsimtarët
	Ndjekja e literaturë pedagogjike	Përsosje profesionale në punë	8	===//===	===//===
	Seminar me arsimtarët sipas konceptit të ri	Aftësimi i arsimtarëve për përpilim të planit mësimor më të përsosur	16	Punë këshilldhënëse-konsultative	Arsimtarët-drejtori
	Prezentim i të dhënave të fëmijëve të Kl. I	Fleta me të dhënat e nx. për nxënësit e klasës së I. për arsimtarëte klasave të para	16	Raport	Pedagogu-Psikologu
Tetor 168 - orë	Aktivitete me organizatën e fëmijëve	Shënimi i javës fëmijrore dhe pranimi i nxënësve të kl I në organizat	16	Programi	Pedagogu,Psikologu,drejtori, kujdestarët e klasave
	Aktivitete me bashkësin e nxnësve(EKO-standardet)	Formimi i këshillit të bashkësis së nxënësve	24	===//===	Kujdestarët e klasve

	Punë këshilldhënëse-konsultative me udhëheqësit e paraleleve	Formimi i bashkësis së klasave, i këshillit prindor	16	===//===	Udhëheqësit e paraleleve- drejtori
	Përcjellja e mësimit të rregullt dhe aktiviteteve jashtëmësimore	Adaptimi i nxënësve të kl VI VI	40	===//===	Arsimtarët lëndor dhe klasor
	Punë këshilldhënëse-konsultative me arsimtarët e klasës I,II, III,IV dheV.	Ndihmë arsimtarëve të ri, Aplikimi TIK- në arsim(mësimi interaktiv)	16	===//===	Pedaggu,PsikologuDrejtori,ars.kl ulta
	Punë këshilldhënëse –konsultative me kolegët	Ndihmë arsimtarëve fillestar	8	===//===	Pedagogu- Psiholog
	Punë me arsimtarët e klasës VII,VIII,IX	Realizimi i notimit në kohë, ndjekjen e rrealizimit të programit mësimor	8	Punë këshilldhënëse	Pedagogu-arsimtarët
Nëntor 176-orë	Ndjekja e numrit të nxënësve të notuar dhe numrin e notave të dobëta për çdo lëndë	Analiza e suksesit në trmujorin e parë	24	Instrument për shënime(tabelar)	Drejtori-Pedagogu Direktor Pedagog
	Përpunimi i rezultateve	Analiza nga testimi i realizuar	16	Analizë	===//===
	Përgatitje të temës profesionale: “Metodat bashkëkohore(ineraktive) dhe notimi formativ dhe sumativ.	Përsosje profesionale e kuadrit mësimor	16	===//===	Pedagogu-Psikologu
	Ndjekja e mësimit të rregullt dhe aktiviteteve jashtëmësimore	Vlerësimi dhe notimi i nxënësve	16	Vizita,konsultime	Mësuesit e mësimit klasor dhe lëndor
	Orë klase në klasën e VII ,VIII dhe IX.	Si, deri te suksemi më i mirë	8	Orë mësimore	Nxënësit dhe ars.lëndor

	Vizitë shkollave periferike Hospitim në orët e rregullta mësimore	Ndjekja e realizimit të mësimit,notimit dhe problemet eventuale me nxënësit	24	Biseda,kontrollë, vëzhgim	Pedagogu-Drejtori
	Anketë me nxënësi e e klasësVI, VII dhe VIII dhe IX.	Hulumtimi i njohurive për shëndet seksual. Punë analitike – kërkimore	24	Anketë	Pedagogu-Psikologu
	Punë këshilldhënëse –konsultative me pri ndërit dhe nxënësit(Këshillimi i prindërve)	Probleme të paraqitura tek disa nxënës, mungesa në orë,dhe sjellja jo e mire notat e dobëta.	16	Biseda Razgovor (Këshillimi i prindërve)	Prindërit ,nxënësit
Dhjetor 160- orë	Punë këshilldhënëse me nxënësit	Nxënësit me tre e më tepër nota të dobëta në tremujorin e parë	16	Biseda	Nxënësit
	Punë këshilldhënëse me prindërit	Përmirësimi i suksesit të nxënësve që kanë tre e më tepër nota të dobëta në trmujorin e pare.	24	Këshillimi prindërve i	Prindërit
	Anketë me prindërit:	Sa është gatishmëria e tyre për ligjerim të kësaj teme në mësim	8	Anketë	Prindërit
	Testim në klasat e treta në gjuhë shqipe	Ndjekja e diturive të nxënësve, ndjekja e gjeneratës	16	Testim	Mësim klasor
	Përpunimi i rezultateve	Analizë e testimit të realizuar	16	Analizë	Mësim klasor

Raport për gjysmëvjetorin e parë, viti shkollor 2023/2024 për punën e Psikologes – Zulihare Osmani

1. Adoptimi i fëmijëve në klasë të parë

Gjatë fillimit të vitit shkollorë janë realizuar vizita të shpeshta me nxënësit e klasave të para për të kuptuar sa janë adaptuar nxënësit si fillestar. Gjatë vëzhgimit vërejta që nxënësit pak a shumë, duke e patur parasysh edhe kohën e shkurtër të kaluar bashkë, janë adaptuar në mes veti, me arsimtaren si dhe me ambientin në klasë. Shoh bashkëpunim midis tyre, socializim si dhe harmoni midis tyre.

Klasa karakterizohet me orar kohorë të pregaditur, strukturë të mirë organizuese, ambient të këndshëm, klimë pozitive pune, materiale didaktike si dhe të shpenzueshme. Programi i cili realizohet në klasën bashkëkohore është fleksibil dhe i adaptueshëm sipas nevojave konkrete të nxënësve, nisur nga interesat e tyre dhe i vazhdon të njëjtat. Suksesi i nxënësve ndiqet vazhdimisht dhe prindërit informohen për çdo situatë që mund të krijohet në klasë.

2. Identifikimi i nxënësve me vështirësi në të mësuar

Fokusi i punës është identifikimi, vlerësimi, trajtimi i fëmijëve me vështirësi në të nxënë, çregullime të të folurit, të vëmendjes dhe hiperaktivitetit, sjelljes dhe problematikave të ndryshme emocionale. Një ndër synimet kryesore është edhe informimi, sensibilizimi dhe avokacia për këtë target grup. Në shërbimet që ofrohen përfshihen dhe trajnime me prindër, mësues, psikolog rreth problematikave psiko-sociale.

3. Përpunimi statistikor dhe analiza e suksesit të nxënësve

Ndjekja e të notuarit dhe numri i notave të dobëta sipas lëndëve dhe sipas klasave, material i shkruar dhe të dhëna nga ditari elektronik.

4. Punë këshillëdhënëse dhe mënyra më e drejtë për kalimin e problemeve

Gjatë gjithë kohës janë realizuar këshillime me nxënësit dhe prindër për probleme të ndryshme, për zgjedhjen e atyre problemeve si dhe për tu arritur një sukses më i mirë, ku është diskutuar ulja e suksesit në mësim/nota negative në tre ose më shumë lëndë/ulje e ndjeshme e suksesit të përgjithshëm në periudhë të shkurtër (një tremujorsh), vijim jo i rregullt në mësim, sjellje e papërshtatshme në shkollë, dhe tema të ndryshme. Rreth mbarëvajtjes së procesit mësimorë në shkollën tone.

5. Ndjekja dhe zbulimi i shkaqeve për suksesin e dobët tek disa nxënësit

Fëmijët me vështirësi në mësimnxënie, kanë zhvillim më të ngadalshëm në aftësitë e përgjithëshme kognitive, mësojnë më ngadalë dhe kanë të arritura më të ulëta në pjesën më të madhe të lëndëve mësimore, gjegjësisht kanë nevojë për më tepër kohë për përvetësimin e materilait mësimor, i

arrijnë vetëm qëllimet më të ulëta mësimore. Fëmijët të cilët kanë vështirësi specifike në mësimnxënie janë më pak të suksesshëm ose më pak të suksesshëm gjatë përmirësimit të diturive dhe shkathtësive në fusha të caktuara të mësimnxënies, (lexim, shkrim, matematikë). Këta janë nxënës të cilët paraqiten probleme në zhvillimin e hershëm dhe kanë vështirësi lidhur me vëmendjen të mbajturit mend, të menduarit, koordinimin, komunikimin, leximin, shkrimin, matematikën, por edhe me zhvillimin e shkathtësive sociale dhe pjekurinë emocionale. Këta fëmijë më së shpeshti kanë probleme me pranimin, përpunimin dhe reprodukimin e informatave.

6. Ndjekja e notimit dhe mungesave të nxënësve

Punë këshillëdhënëse me nxënësit që kanë 3 e më shumë nota të dobëta, 10 ose më shumë mungesa pa leje. Konsultime, bisedë, ndjekje.

7. Shqiptim I masave pedagogjike tek disa nxënës

Pas konsultimeve me nxënësit problematik, qortim me goj, qortim me shkrim, 3 nota të dobëta, 10 e më shumë mungesa pa leje, pas thirjeve prindërore dhe mos paraqitjes së prindërve në konsultim, si dhe mos përmirësimit të nxënësit kemi shqiptuar masa pedagogjike.

8. Konsultime me prindër, dhe informimi për problemet e fëmijëve të tyre

Prindërit vazhdimisht janë informuar për çdo situatë që kanë krijuar fëmijët e tyre në shkollë, poashtu ju kemi dërguar thirrje prindërore për arsye të mos ndjekjes së rregullt të nxënësve në mësim, sjellje jo adekuate në shkollë si dhe për arsye të suksesit të dobët në mësim.

9. Vëzhgim nëpër orë mësimore

Qëllimi i vëzhgimit në orë mësimore është që të kuptojmë rëndësinë dhe natyrën e vëzhgimit të ores për zhvillim profesional të mësimitdhënësve, të zhvillojnë aftësi për të përmbledhur prova gjatë vëzhgimit të orës dhe ti interpretojnë ata prova. Ti identifikojnë pikat e forta dhe fushat e dobëta që kanë nevojë për përmirësim, ta iniciojnë dhe mbështesin procesin e vëzhgimit të kolegëve në nivelin e shkollës.

9. Anketa dhe përpunimi i saj

Gjatë muajit tetor dhe nëntorë është realizuar dhe përpunuar anketa me nxënësit dhe me prindërit në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor, higjienës dhe kushteve për punë në shkollën tone, ku të anketuarit janë shumë të kënaqur me mbarëvajtjen e procesit mësimorë në shkollën tone.

10. Shërbime tjera të ndryshme

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar shërbime të ndryshme nga ana ime ndaj arsimtarëve në nevojë. Pregaditje e dokumentacioneve pedagogjike, procesverbale, vërtetime, kërkesa, ftesa, ditari elektronik. Përfshirja në aktivitete dhe projekte të ndryshme të cilat janë realizuar nga ana e arsimtarëve në bashkëpunim me nxënësit në shkollën tonë, e të tjera.

Raport për punën e edukatores speciale - LINDIHANA EBIBI

Fushat programore për punë

1. Puna me nxënës

- Mbështetje e nxënësve në mësim
- Ndjekje dhe mbështetje e zhvillimit të nxënësve

2. Puna me arsimtarët

- Mbështetja e arsimtarëve për procesin arsimor
- Mbështetja e arsimtarëve për punë me nxënës

3. Puna me prindërit

- Këshillime individuale
- Këshillime me prindërit për gjendjen emocionale të nxënësve.

4. Bashkëpunimi me komunitetin

- Bashkëpunim me komunitetin lokal, vetëqeverisjen lokale. BZHA, MASH dhe organizatat ndërkombëtare, sektori i OJQ –ve komunë.

5. Zhvillim profesional dhe bashkëpunim me shërbimin e shkollës

- Mbështetje e zhvillimit profesional dhe bashkëpunimit në shkollë
- Vlerësimi i nxënësve në klasë të parë evidentimi i nxënësve me nevoja të veçanta

6. Punë hulumtuese kërkimore-analitike

- Hulumtim në punën edukative
- Struktura e shkollës organizimi dhe klima
- Klima e shkollës, krijim i mjedisit të sigurtë dhe pjesëmarrje demokratike.

Fusha e aktivitetit	Përmbajtja e punës	Realizuesit dhe bashkëpunëtorët	Koha e realizimit
	Përpunimi personal i programit vjetor	Edukatori special dhe rehabilituesi	Gusht2023
	Pjesëmarrje në përgaditjen e programit vjetor të shkollës, pjesëmarrje në përpilimin e planit zhvillimor ,pjesëmarrje në përgaditje të raportit të shkollës etj	Shërbimi profesional Drejtori	Gusht 2023
Puna me nxënës	Formimi i paraleleve, të klasave të para pranimi dhe shpërndarja e nxënësve me nevoja të veçanta nëpër klasa	Shërbimi profesional Arsimtarët Prindërit	Shtator-Tetor 2023
	Vëzhgim në orë mësimore me qëllim identifikimin e nxënësve me nevoja të vecanta.	Arsimtarët Shërbimi profesional	Shtator- Tetor 2023
Dhënia e përkrahjes së duhur dhe monitorimi i suksesit të nxënësve me pengesa në procesin mësimor.	Bisedë me nxënësit problematik,që të përfshihet përshtatur me mjedisin dhe shkollën	Arsimtari Shërbimi profesional	Në vazhdimësi
	Mbajtje e dosjes për secilin nxënës për shqiptim të vërtetave me shkrim ,mosrespektim të kodeksit të nxënësve	Arsimtari Shërbimi profesional	Në vazhdimësi

Punë me prindërit	Bashkëpunim me prindërit e nxënësve me pengesa në procesin mësimor., për të kuptuar fëmijët e tyre dhe ti mbështesin ato	Prindërit Nxënësit	Në vazhdimësi
	Informon prindërit e nxënësve me NV për të drejtat, detyrimet dhe përfitimet që ju takojnë dhe i drejton ato tek institucionet përkatëse	Edukatori special dhe rehabilituesi	Në vazhdimësi
	I ndërlihdh karakteristikat e nxënësve me format e mësimi praktik	Edukatori special dhe rehabilituesi	Sipas nevojës

Bashkëpunimi me institucionet tjera	Bashkëpunim me institucione shëndetësore dhe institucione për zbulim të hershëm diagnostifikim, dhe trajtimin të hershëm të nxënësve me pengesa në procesin mësimor.		Në vazhdimësi
	Bashkëpunim me shërbimin profesional të shkollës. Institucionet kompetente MASH dhe byrosë për zhvillimin e arsimit BZhA shoqatat dhe organizatat ndërkombëtare, sektori i OJQ – ve komunë.		
Zhvillim profesional i edukatorit special dhe rehabilituesit	Pjesëmarje në trajnime, seminare që parashihen gjatë vitit shkollor 2023-24		Sipas nevojës
	Pjesëmarje në mbledhje të aktiveve profesionale të mësimin lëndor dhe klasor në tema të ndryshme		Në vazhdimësi
Puna analitike-hulumtuese	Realizon hulumtime aksionale për përmirësimin e mësimin. Aktivitet për 3Dhjetorin ditën ndërkombëtare të fëmijëve me aftësi të kufizuara	Edukatori special dhe rehabilituesi Shërbimi profesional	Sipas nevojës
Organizimi dhe strukturimi i shkollës	Në mënyrë periodike e ndjek dhe përpunon dokumentacionin e nxënësve me pengesa në procesin mësimor	Edukatori special dhe rehabilituesi	Në vazhdimësi

	Kujdeset për kyçe të nxënësve me pengesa në procesin mësimor në organet e bashkësisë së nxënësve (u ndihmon bashkësisve të nxënësve që t'i pranojnë nxënësit me pengesa në procesin mësimor. Realizimi i anket me mësimdhënësit Përrpunimi i statistikës në fillim të vitit shkollor ,tre mujorin e parë dhe gjysmëvjetorin e dytë Pjesëmarje në seminare Kordinator në testimin shtetëror me klasat e e V-ta Kordinator në testimin shtetëror Talis Anëtar në regjistrimin e nxënësve për shtesa financiare.	Edukatori special dhe rehabilituesi	
--	---	-------------------------------------	--

**Bibliotekisti
Asllan Emini**

Raport për pranimin e librave në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2023/2024

Tituj e librave

Sasia

Klasa e I-rë

Gjuhë shqipe -Vebi Kadriu

Matematika - Irena Bogdanovska

Shkenca Natyrore -Nela Slezenskova

Shoqëri-Biljana Kamçevska

56-libra

56-libra

56-libra

56-libra

Klasa e II-të

Gjuhë shqipe -Vebi Kadriu

Matematika - Irena Bogdanovska

Shkenca Natyrore -Nela Slezenskova

Shoqëri-Glikeria Iloska

60 libra

60 libra

60 libra

60 libra

Klasa e III-të

Gjuhë shqipe -Vebi Kadriu

Matematika - Irena Bogdanovska

Shkenca Natyrore -Nela Slezenskova

Shoqëri-Bijana Stotonovska

62 libra

62 libra

62 libra

62 libra

	Klasa e IV-të Gjuhë shqipe -Vebi Kadriu Matematika – Tatjana Atanasovska Shkenca Natyrore -Nela Slezenskova Shoqëri-Anita Angelofska	54 libra 54 libra 54 libra 54 libra 54 libra
	Klasa e V-të Gjuhë shqipe -Vebi Kadriu Matematika – Tatjana Atanasovska Shkenca Natyrore –Icko Gjorgovska Histori dhe Shoqëri-Anita Angelofska	82 libra 82 libra 10 libra
	Klasa e VI-të Gjuhë shqipe –Asllan Amiti Matematika –Krutun Rasimi Shkenca Natyrore –Icko Gjorgovska	69 libra 69 libra 69 libra

	Klasa e VII-të Gjuhë shqipe –Fejzi Bojku Matematika –Sue Pembertod Biologji-Mary Jones Informatka-Andijana Tondovska	10 libra 18 libra 18 libra 19 libra
	Klasa e VIII-të Matematika –Sue Pemberton Fizik-Mari Jones Biologji-Mary Jons Kimi-Daren Forbes Gjeografi-Kole Panvlov Edukata Qytetare-Biljana Shotorovska Arsim fizik dhe shëndetësor-Marian Karapançevski	16 libra 16 libra 16 libra 16 libra 4 libra 4 libra 4 libra
	Klasa e IX-të Matematika –Sue Pembertod Fizik-Mari Jones Biologji-Mary Jons Kimi-Foger Noris Edukat Qytetare-Tatsana Georgievska Arsim Muzikor-Vera Angelovska	21 libra 21 libra 21 libra 21 libra 70 libra 70 libra

4. Organizimi i mësimdhënies

Sipas kalendarit përcaktohet organizimi i vitit shkollor , viti shkollor në shkollat fillore filloi më 1 shtator 2023 dhe përfundon më 31 gusht 2024. Viti shkollor filloi me 1 shtator, perfundoi me 14 qershor. 2024 . Gjatë vitit shkollor janë parapar 180 ditë mësimore. Para fillimit të vitit shkollor është bërë një analizë e gjendjes aktuale të shkollës, në lidhje me paisjet kompjuterike të shkollës, gjendjen e internetit dhe kapacitetet hapësinore të shkollës,. Mësimi në shkollën qendrore zhvillohet në një ndërtesë katër katëshe ku zhvillohet mësimi teorik dhe praktik.I njëjti zhvillohet në dy ndryme,ndrimi i paraditës dhe i pasditës.Mësimi paradite fillon në ora 07:30 gjersa ndrimi i pasditës në ora 13:30 Mësimi në shkollë realizohet në gjuhën shqipe, gjersa mësohen edhe këto gjuhë të huaja: gjuhë angleze te të gjitha paralelet si gjuhë e huaj (Gjuhë e parë) gjersa gjuha frënge si gjuhë e dytë.

Të gjitha dokumentet e nevojshme për organizimin e suksesshëm të procesit arsimor janë përgatitur në kohën e duhur:

- Programi vjetor për punën e shkollës

- Orari për lëndët obligative, orët e lira në shkollë, mësimi shtues dhe plotësues.

- . Të gjithë mësimdhënësit kanë dorëzuar me kohë planet vjetore dhe tematike, plane për mësim shtesë dhe plotësues, planifikim për orët e lira në shkollë.

Drejtori dhe shërbimi profesional kanë përcjellur në vazhdimësi punën e mësuesëve, kanë kontrollëuar evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik, kanë vizituar klasat,... dhe më pas bashkimi dhe vizita në realizimin e përkohshëm të orëve dhe ri-mësimdhënies nxënësit i bashkohen mësimi në kohën e duhur, respektojnë kodekset e shkollës, mësuesit kontrollëojnë rregullisht frekuentimin e nxënësve, regjistrojnë frekuentimin në ditarin paralel dhe raportojnë menjëherë ngjarjen tek drejtuesit e klasës dhe tek shërbimi psikologjik pedagogjik.

Drejtori i shkollës bashkë me shërbimin pedagogjik ka realizuar në kohë mbledhjet me këshillin e shkollës ,mbledhjet prindërore .

4.1 Aktivitetet e ndërmarra për përmirësimin e kushteve të punës.

- Me qëllim të përmirësimit të kushteve për realizimin e punës edukative-arsimore, pamjes estetike dhe klimës së përgjithshme të shkollës, gjatë vitit shkollor 2023-2024 zhvillohen këto aktivitete:
- Shp-Senakos është furniza me një fotokopje të madhe dhe kompjuter për nevojat e nxënësve dhe mësimeve
- Furnizimi i vazhdueshëm i shkollës me mjete pune dhe 3 projektor të ri.
- Në shkollën periferike të fshatit Senakos u bë mbulimi i shkallëve me granit nga ana e mësimeve Mirsad Osmani dhe Rizvan Asani ,kurse për gjërat materiale u kujdesv depoja Evro Kom
- Në shkollën periferike Senakos u bë vendosja e anësoreve nga alumini (pamakëve të shkollës)
- Në shkollën qendrore në Negotinë përkatësisht në zyrat u bë vendosja e perdeve veneciane nga ana e ndërmarrjes Torino Rolet(parmak)
- Në shkollën qendrore në Negotinë u vendosën rrethore të reja me ndimën e personelit teknik.
- Në shkollën periferike në Kalisht u vendosën rrethoret,me ndimën e personelit teknik.

4.2 Llojet e mësimeve:

Mësimi u zhvillua në përputhje me planin dhe programet e miratuara nga MASH, ë fillim të vitit shkollor është hartuar orari i realizimit të mësimeve , ai rregullisht plotëson përmbajtjet e mëposhtme:

- Lëndët e obligative
- Lëndët zgjedhore.
- Mësim shtues
- Mësim plotësues
- Orë të lira në shkollë

